



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 938 Prot.
2023

Tiranë, më 10 . 08 .

V E N D I M

Nr. 162 , datë 10 . 08 . 2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 151 Regj., datë 31.07.2023, të shtetasit S. S, kundër Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRShSSH) Korçë, në të cilën pretendohet për diskriminim në formën e shoqërimit, për shkak të “aftësisë së kufizuar” të të birit.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, S. S, është prind i një fëmije, i cili që në moshën 3 vjeçare është diagnostikuar nga Komisioni Mjekësor për Caktimin e Aftësisë për Punë (KMCA) Tiranë, me çrregullime të spektrit autik.

Bazuar në këtë diagnozë të djalit, prej 8 (tetë) vitesh edhe ai ka përfituar pagesën e kujdestarisë së tij, pasi fëmija ka nevojë për përkujdesje të vazhdueshme, gjë që e ka penguar atë të punojë. Z. S është shprehur se deri në muajin maj 2023, ka përfituar pagesën e kujdestarisë në të njëjtën vlerë me atë të të birit, në shumën prej 12.153 lekësh, ndërsa nga muaji maj 2023 e në vazhdim kjo pagesë i ka zbritur në vlerën prej 9.723 lekësh.

Ankuesi pretendon se zbritja e pagesës së kujdestarisë si ndihmës personal i të birit është diskriminuese dhe se ai me këtë pagesë që merr nuk mund të mbulojë as shpenzimet jetike të fëmijës së tij.

¹ Në vijim do t'i referohemi me akronimin: KMD.

Në përfundim, subjekti ankues, ka kërkuar nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (DRShSSH) Korçë, lidhur me masën e pagesës së tij si ndihmës personal i personit me aftësi të kufizuar (djalit).

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përgjithësim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Nga shqyrtimi paraprak i parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga subjekti ankues pranë KMD-së, konstatohet se, në dokumentin “Vërtetim për aftësinë e kufizuar”, për djalin e tij, të Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, Korçë, të cilin ankuesi ia ka bashkëlidhur ankesës, evidentohet të jetë shënuar:

“Diagnoza: Çrregullim i Spektrit Autik

.....

4. *Kategoria e aftësisë së kufizuar: Autizëm.*

Niveli i dëmtimit të aftësive funksionale: I rëndë

Përcaktimi i përfitimeve:

(përfitime në para (fëmijë 2-18 vjeç) : Niveli i rëndë

Ndihmësi personal:

Niveli i 3 (Mbështetje e herë pas herëshme)

Vlefshëmëria: 2 vite, nga data 24.04.2023 – 01.05.2025”.

Ankuesi pretendon se deri në muajin maj 2023 ka përfituar pagesën e kujdestarisë në masën 12.152 lekë, por nuk ka depozituar asnjë provë apo dokument për sa më sipër. Ndërsa pretendon se nga muaji maj e në vazhdim përfiton shumën prej 9.723 lekësh.

Komisioneri thekson faktin se, pavarësisht se ankuesi nuk depozitoi dokumentacion apo të dhëna të tjera për të vërtetuar se sa ishte pagesa e përfituar më parë prej tij (para muajit maj 2023) dhe se si ishte vlerësuar ai, në cilin nivel përfitimi (të tretë apo të katërt), ka analizuar se si dhe cili do të ishte përfitimi i ankuesit si ndihmës personal i personit me aftësi të kufizuar, bazuar në përcaktimet e akteve normative sipërcituar.

Bazuar në deklarinimin e subjektit ankues, rezulton se ai nuk është dakordësuar me përcaktimin e DRShSSH Korçë, lidhur me masën e e përfitimit të pagesës së kujdestarisë si ndihmës personal i personit me aftësi të kufizuar, por nuk e ka kundërshtuar atë pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave/ShSSH. (Nuk ka depozituar një akt kundërshtimi pranë KMD-së).

Lidhur me pretendimet e ankuesit për sa i takon përcaktimit të vlerës së pagesës si ndihmës personal i personit me aftësi të kufizuar, Komisioneri ndjek analogjinë si me pretendimet e ankuesve për mosmarrjen në shqyrtim të dokumentacionit të tyre nga Komisioni Shumëdisiplinor i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, pranë DRShSSH Korçë apo vendimarrjes së këtij të fundit jo në favor të ankuesit/ankuesve; ku Komisioneri ka vlerësuar se, rimarrja në shqyrtim e vendimeve të këtyre organeve, të specializuara mjeko-ligjore siç janë: Komisioni Shumëdisiplinor i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar apo KMCAP Eprore, nuk bën pjesë në kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi².

Në nenin 10 të Ligjit nr. 57, datë 18.07.2019 *“Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”*, përcaktohet se:

“Përfitues të ndihmës personal janë:

Personat përfitues, që përcaktohen në gerrat a, b, dhe c, të nenit 8, të këtij ligji, të cilët, me vendim të komisioneve të vlerësimit, të parashikuar nga ky ligj, përcaktohen se kanë nevojë për përkujdesje, përfitojnë edhe një ndihmës personal me pagesë”.

Neni 8/c), i këtij Ligji përcakton se:

“Përfitues të pagesës për aftësinë e kufizuar janë:

.....

c) personat me aftësi të kufizuar, të deklaruar të tillë me vendim të Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar”.

² Për analogji citojmë: Vendimin nr.185, datë 28.09.2018, Vendimin nr.55, datë 24.04.2019, Vendimin nr.06, datë 08.01.2020, Vendimin nr. 61, datë 12.06.2020, Vendimin nr. 59, datë 13.04.2021, Vendimin nr. 78, datë 07.05.2021, dhe Vendimin nr. 106, datë 14.06.2021, të KMD, publikuar në ëeb-in e institucionit: www.kmd.al.

Neni 29 i këtij Ligji, shprehet në mënyrë të detajuar për procedurën e ankimimit, në rastet kur aplikuesit/përfituesit nuk janë dakord me vendimmarrjet e komisioneve të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar se:

“1. Aplikuesi për përfitimin e ndihmës ekonomike, kur gjykon se vendimi zyrtar i organit përkatës është i padrejtë dhe personi me aftësi të kufizuar, kur gjykon se i është shkelur një e drejtë e garantuar nga ky ligj, mund të paraqesin ankesë me shkrim pranë bashkisë/njësisë administrative brenda 20 ditëve kalendarike nga marrja e njoftimit. Struktura vendore shqyrton ankesën dhe njofton me shkrim ankuesin brenda 7 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës.

2. Aplikuesi për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe personi me aftësi të kufizuar kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim pranë strukturës rajonale të Shërbimit Social Shtetëror brenda 20 ditëve kalendarike nga marrja e përgjigjes nga struktura vendore, pas ezaurimit të ankimit, të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Struktura rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pas shqyrtimit dhe verifikimit të ankesave, njofton me shkrim të interesuarin dhe njësinë e vetëqeverisjes vendore brenda 14 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës.

4. Aplikuesi për përfitimin e ndihmës ekonomike dhe personi me aftësi të kufizuar, që pretendojnë se u është shkelur dhe/ose mohuar një e drejtë ligjore, gëzojnë të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Vendimi nr. 722, datë 11.11.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësisë së kufizuar, si dhe të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse dhe detyrave të tyre”, përcakton procedurën dhe dokumentacionin e kërkuar për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës së personit me aftësi të kufizuar, si dhe të ndihmës personal të personit me aftësi të kufizuar, në të cilën parashikohet që:

“....

3. Administrimi i procesit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar realizohet nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror.

4. Pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror krijohen komisionet shumëdisiplinore të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, të cilat funksionojnë në nivel rajonal, që përbëhen nga punonjës me kohë të plotë dhe kanë në përbërje, së paku, një mjek dhe një punonjës social për çdo komision, të trajnuar për modelin biopsikosocial të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuar. Çdo komision asistohet nga një punonjës, i cili administron dhe regjistron të dhënat e aplikuesit. Komisionet kryesohen nga përgjegjësi i zyrës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

.....

5. Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror nxjerr vendimin përfundimtar për të gjithë përfituesit e aftësisë së kufizuar, njofton zyrtarisht aplikuesin për vendimmarrjen dhe e pajis me dokumentin përkatës, që përcakton aftësinë e kufizuar.....”.

Në kreun IV, të këtij vendimi “Përfitimet në pagesa dhe shërbime”, parashikohet se:

“1. Pagesa për shkak të aftësisë së kufizuar është një pagesë mujore, që jepet në muajin pasardhës, nga data e vendimit për përfitime, me qëllim përmbushjen e nevojave elementare të lidhura me aftësinë e kufizuar, e cila përfitohet nga personat që janë deklaruar si të tillë me vendim të komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

.....

6. Niveli i aftësisë së kufizuar dhe përfitimet përcaktohen bazuar në vlerësimin biopsikosocial, të kryer nga komisioni shumëdisiplinor.

.....

14. Personat me aftësi të kufizuara me kufizime të rënda apo të thella gëzojnë të drejtën e përfitimit të ndihmësit personal, kur kjo përcaktohet nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

15. Shkalla e nevojës për shërbimet e ndihmësit personal përcaktohet në bazë të vlerësimit biopsikosocial të kryer nga komisioni shumëdisiplinor.

16. Pagesat për shërbime të ndihmësit personal lidhen me pagesat për shkak të aftësisë së kufizuar dhe indeksohen nga Shërbimi Social Shtetëror, në bazë të indeksimit të pensionit social.

17. Pagesat për shërbime të ndihmësit personal u referohen pagesave të përcaktuara në pikat 16 dhe 17, të vendimit nr. 431, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar”.

VKM nr. 431, datë 8.6.2016 “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar dhe të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot”, e Këshillit të Ministrave, në pikën 3, të Kreut IV të tij, ka përcaktuar se, niveli i pagesës për shkak të aftësisë së kufizuar përcaktohet nga komisioni shumëdisiplinor i vlerësimit, në përputhje me udhëzimet e miratuara nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale.

Pika 17, e kësaj VKM-je parashikon se:

“17. Shuma e pagesës e ndihmësit personal, për shërbime të here pas herëshme është 80% e pagesës bazë të aftësisë së kufizuar”.

Urdhri nr. 222/4, datë 31.08.2022 “Mbi zbatimin e VKM nr. 722, datë 11.11.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës, të kritereve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësisë së kufizuara, si dhe të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse dhe detyrave të tyre”, në pikën 3, të tij, përcakton se:

“Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 2/b) të kreut IV, të VKM NR. 431, datë 8.6.2016 “Për përcaktimin e kritereve, të dokumentacionit, procedurave dhe të masës për përfitimin e pagesës së aftësisë së kufizuar dhe të ndihmësit personal dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre në zonat pilot”, për të rritur dhe fëmijë, është 9.723 lekë në muaj, për personat e përcaktuar në pikën 2, të kreut I, të vendimit”.

Nga këqyrja e akteve të depozituara nga ankuesi, Komisioneri vëren se:

- Sipas raportit të Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, Korçë, me datë 24.04.2023, citohet se subjekti ankues në cilësinë e ndihmësit personal të të birit me aftësi të kufizuar, është klasifikuar në nivelin e tretë– mbështetje e herë pas herëshme.
- Bazuar në deklaratimet e ankuesit, fëmija i tij, përfiton pagesën e aftësisë së kufizuar në masën 12.153 lekë.
- Bazuar në parashikimet e mësipërme, të pikës 17, të VKM nr. 431/2016, Komisioneri vëren se, pagesa e kujdestarisë si ndihmës personal, për ankuesin llogaritet sipas formulës: pagesa e ndihmësit personal= 80% x pagesës së aftësisë së kufizuar të PAK të birit, në këtë rast; pra 80% x 12.153 lekë = 9.723 lekë.

Llogaritja e vlerës së përfituar nga ndihmësi personal i personit me aftësi të kufizuar, bazohet në vlerësimin që bëhet në dokumentin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar nga Komisioni i posaçëm shumëdisiplinor i ngritur pranë Shërbimit Social të Drejtorisë Rajonale Korçë.

Pra, nëse ankuesi ka pretendime për masën e përfitimit të kësaj pagese, ky pretendim buron nga vlerësimi i bërë nga ky Komision. Kjo për faktin se ankuesi është cilësuar në nivelin e tretë të përfitimit dhe jo të katërt (mbështetje e përherëshme), mbi bazën e të cilës bëhet edhe përlllogaritja e vlerës së pagesës së kujdestarisë.

Në kreun V³, të këtij vendimi është parashikuar e drejta e ankimimit të aplikuesit, lidhur me procedurën e vlerësimit, në rastet e refuzimit të aplikimit për përfitimet lidhur me përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar se:

“1. Aplikuesi ka të drejtën e ankimimit për procedurën e vlerësimit në rastet e refuzimit të aplikimit për përfitime për shkak të aftësisë së kufizuar. Ankimimi bëhet me shkrim, brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike, nga data e marrjes së njoftimit të vendimit nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pranë komisionit të shqyrtimit të ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, e cila shqyrton dokumentacionin e ankimesit, kryen intervistën sipas formularit 6, bashkëlidhur këtij vendimi dhe merr vendimin përfundimtar. Në rastet kur kërkesa pranohet, personit i lind e drejta e marrjes së përfitimeve që nga muaji pasardhës, nga data e marrjes së vendimit për refuzim nga komisioni.

2. Personi me aftësi të kufizuar, që pretendon se i është shkelur dhe/ose mohuar një e drejtë, gëzon të drejtën për të ngritur padi në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, pasi ka ezauruar shkallët e ankimimit administrativ. Personit i lind e drejta e marrjes së përfitimeve, sipas afateve të përcaktuara në vendimin e gjykatës”.

³ V. E drejta e ankimimit

Bazuar në sa më sipër, pas marrjes dijeni lidhur me masën e përfitimit të pagesës së ndihmësit personal, për shkak të aftësisë së kufizuar të personit në kujdestari, nëse personi nuk është dakord, mund ta apelojë atë pranë komisionit të shqyrtimit të ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Aplikuesi ka të drejtën e ankimit për procedurën e vlerësimit edhe në rastet kur ai pretendon për nivelin e përfitimit të pagesës mujore për shkak të aftësisë së kufizuar apo pagesës së kujdestarisë/ ndihmësit personal të personit me aftësi të kufizuar.

Në rastet e ankimit të vendimit të komisioneve shumëdisiplinore të nivelit të parë, për nivelin e përfitimit të aftësisë së kufizuar, Komisioni i nivelit më të lartë në SHSSH, Komisioni Shumëdisiplinor Epror, vlerëson nëse ankimi është i pranueshëm dhe i bazuar, dhe vendos përfundimisht me anë të një vendimi i cili në vetvete përbën një akt administrativ. Përgjigjja e argumentuar, pra vendimi i arsyetuar që marrin këto komisione, lidhet kryesisht me vlerësimin dhe caktimin e diagnozës mjekësore.

Me vlerësimin e ri bio-psiko-social, personat me aftësi të kufizuar mbështeten financiarisht sipas shkallës së sëmundjes dhe kompleksitetit të saj, gjë e cila përcaktohet nga komisionet e dedikuara, multidisiplinore, të cilat kanë në përbërje figura profesionale mjekë dhe punonjës socialë.

E njëjta logjikë ndiqet edhe për vlerësimin e ndihmësit personal të personit me aftësi të kufizuar, pasi është ky komision që vlerëson nëse, personi ka nevojë për mbështetjen e herë pas herëshme të ndihmësit personal apo mbështetje të përherëshme, dhe varësisht nga ky përcaktim vjen edhe niveli i pagesës së kujdestarisë.

Për shkak të natyrës specifike apo natyrës juridike të marrëdhënies që krijohet gjatë vlerësimit të aftësive për punë, këto vendime mund të merren vetëm nga mjekët e specializuar pranë Komisioneve shumëdisiplinore Rajonale dhe Epror Komisioni i Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar është një ekip i përzgjedhur, i përbërë nga së paku një mjek i specializuar dhe të paktën një psikolog, të cilët janë përgjegjës për kryerjen e vlerësimit të aplikuesve për përfitimet në para dhe/ose në natyrë për shkak të aftësisë së kufizuar, bazuar kryesisht në dokumentet e përgatitura nga institucionet shëndetësore.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri çmon se, vlerësimi nëse ankuesi, bazuar në vlerësimin bio-psiko-social të fëmijës së tij, duhet apo jo të rezultojë fitues i përfitimeve të caktuara për shkak të aftësisë së kufizuar, apo se sa është kjo vlerë, mund bëhet vetëm nga komisionet e specializuara për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe për ndihmësit e tyre personal.

Në përfundim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i rekomandon subjektin ankues që, bazuar në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar në ligjin 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, dhe në ligjin

nr. 57, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”; nëse nuk do të jetë dakord me vendimmarrjen e Komisionit dhe cilësimin që ai ka bërë për kategorizimin në nivelin e tretë (mbështetje e herë pas herëshme), ai ka të drejtën e ankimit, me shkrim, brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike, nga data e marrjes së njoftimit të njoftimit/vendimit nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, pranë komisionit të shqyrtimit të ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Pra, fillimisht ankuesi duhet të ezaurojë ankimin administrativ, pranë komisionit të shqyrtimit të ankesave në DPSHSSH, dhe nëse nuk do të jetë dakord as me përgjigjen apo vendimmarrjen e këtij të fundit, i cili është i formës së prerë por jo përfundimtar, mund t’i drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për ta kundërshtuar gjyqësisht atë.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/b, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se: “Ankesa nuk pranohet përbën abuzim me të drejtën e ankimit para Komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i rekomandon subjektit ankues, që, për problematikën e tij, t’i drejtohet për ofrimin e ndihmës ligjore falas, Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike⁴, ose Shërbimit Ligjor Falas⁵.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues S. S, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.

KOMISIONERI

⁴ Me adresë: Pranë Ministrisë së Drejtësisë, Blv. “Zogu i Parë”, Tiranë.

⁵ Me adresë: Bulevardi: “Bajram Curri”, Pall: “Agimi”, Shk. 18, Ap. 322, Tiranë, Nr.tel: 0422 53113.

Fusha: Të mira dhe shërbime
Shkaku: AK